



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

21 prill 2010, Prishtinë

**VENDIM I KËSHILLIT TË KPM-SË
PËR SHTYERJEN E AFATIT PËR PAGESË TË TAKSËS PËR
LICENCË DERI MË 31 MAJ 2010**

Në takimin e Këshillit të KPM-së, të mbajtur më 21 prill 2010 është shqyrtuar lista e të licencuarve të cilët nuk kanë arritur ta bëjnë pagesën e taksës për licencë të KPM brenda afatit të paraparë me vendimin e Këshillit të KPM-së të datës 25 janar 2010. Duke marrë parasysh se një numër i të licencuarve akoma nuk kanë arritur ta kryejnë obligimin ligjor qe kane per pagesen e taksës per licencë, Këshilli i KPM-së ka vodosur që afati i fundit për pagesën e taksës për licencë për vitin 2010, të jetë data **31 maj 2010**, për të gjitha subjekte transmetuese (Radio dhe TV), operator kabllor dhe ofrues të shërbimeve programore të cilat nuk kanë arritur ta bëjnë pagesën e taksës për licencë deri me tanë.

Vendimi i shtyrjes së afatit për pagesë të taksës për licencë, nuk i liron të licencuarit nga pagesa edhe e kamates per shkak te vonesës. Të licencuarit kanë qenë të obliguar të bëjnë pagesën e taksës për licencë deri më 5 mars 2010, kështu që për çdo muaj vonesë pas kësaj datë, në kryerjen e obligimit për taksë për licencë, do të aplikohet kamata në baza mujore njësoj siç është e përcaktuar nga Administratat Tatimore e Kosovës (ATK) për vonesa të pagesës së taksës.

Këshilli i KPM-së i udhëzon subjektet transmetuese, ofruesit e shërbimeve programore dhe operatorët kabllorë që sa më parë të kryejnë obligimin ligjor duke e bërë pagesën e plotë të taksës për licencë të KPM, në mënyrë që të veprojnë në pajtim me Ligjin e KPM-së dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me taksën për licencë.

Dështimi në pagesën e plotë të taksës për licencë të KPM-së për vitin 2010, brenda afatit te percaktuar do kete pasoja ligjore qe mund te cojne edhe ne revokimin e licences nga ana e Keshillit të KPM-së.

Agim Sopi
Kryesues i Këshillit të KPM-së

KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA

Ref:1004/0510/KKPM/l1